



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 10.09.2024

PROCESVERBAL

Dëgjimi buxhetor me qytetarë për Buxhetin e vitit 2024
I organizuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa
I mbajtur më 04.09.2024 (e mërkurë)
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Dëgjimi buxhetor me qytetarë për Buxhetin komunal të vitit 2025, i organizuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa, është mbajtur sipas Njoftimi të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe rrjetin social Facebook.

Njoftimi në uebfaqen zyrtare:

<https://k.k.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/08/Njoftimi-KPF.pdf>

Njoftimi në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/o7y7hEd7PpowgpQJ/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/uPeT7w9PuP6eKRfo/>

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

01 Nr. Br. 400/01-24.02/24
10.09.2024
Dragash • Dragaš

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragas

Mr. Nr. _____
_____ 20____
Dragash • Dragas

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **33 pjesëmarrës, prej tyre 21 meshkuj dhe 12 femra.**

Hapjen e takimit e ka bërë kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Dragashti, znj.Arijeta Skeraj.

Arijeta Skeraj: I nderuar nënkryetar i Komunës, z.Resul Fetahu, i nderuar drejtor i Financave, z.Qamil Kolloni, të nderuar anëtarë të KPF-së, përfaqësues të OJQ-ve, e nderuar zyrtare për Barazi Gjinore, përfaqësues i DEMOS-it, të nderuar qytetarë dhe ju të tjerë të pranishëm! Fillimisht, më lejoni që t'ju uroj mirëseardhjen dhe t'ju falënderoj që keni gjetur kohë për të marrë pjesë në këtë Dëgjim buxhetor. KPF-ja, si mekanizëm i Kuvendit të Komunës është i obliguar që, në bazë të dispozitave ligjore të mbajë dëgjim publik me qytetarë për të shqyrtuar dhe prezantuar projekt-buxhetin e Komunës, të cilin e harton ekzekutivi lokal, duke u bazuar në dëgjimet buxhetore paraprake, kërkesat e qytetarëve dhe propozimet e këshillave të fshatrave. Projekt-buxheti na është dorëzuar nga kryetari i Komunës sipas afateve ligjore, para datës 1 shtator. Pas marrjes së ndonjë kërkesë apo propozimi eventual nga ana juaj, ky dokument do të shkojë për miratim përfundimtar në Kuvendin e Komunës dhe duhet të votohet nga delegatët e Kuvendit, më së largu deri në fund të muajit shtator. Projekt – buxheti, duke përfshirë Listën preliminare të investimeve kapitale dhe dokumentet e tjera të nevojshme, është i publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës, ku keni pasur mundësinë që ta shkarkoni dhe të informoheni lidhur me përmbajtjen e tij. Listën preliminare të investimeve kapitale besoj se e keni marrë edhe si kopje fizike këtu në sallë. Para se të vazhdojmë me kërkesat dhe propozimet tuaja, fillimisht po ia kaloj fjalën drejtorit të Financave, z.Qamil Kolloni, qa ta bëjë një prezantim për Porjekt-buxhetin e hartuar nga ekzekutivi lokal.

Qamil Kolloni: Ju faleminderit, kryesuese! Përshëndetje, të pranishëm! Kam kënaqësinë që para jush të paraqes Buxhetin komunal për vitin 2025-2027. Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kryetari ka dorëzue buxhetin në Kuvendin Komunal, dhe para se të merret vendimi, para datës 1 shtator t'i nënshtrohet edhe një herë diskutimit publik, me kusht se prioritetet të cilat i kemi vendos nuk kanë ardhë si rrjedhojë e momentit, po si kërkesa të qytetarëve që kanë pas disa takime buxhetore nëpër fshatra, kemi pas takime buxhetore me sektorin e Arsimit, Shëndetësisë, me qytetarë, me të rinj, dhe para se të shkojë në miratim, kemi sjellë edhe një herë në KPF, edhe një bashkëbisedim me qytetarët, që vërejtjet të cilat mund të paraqiten, prioritetet të cilat mund të paraqiten, të mund t'i inkorporojmë me rastin e marrjes së vendimit nga delegatët e Komunës sonë. Prandaj, pa humbur kohë, po ju jap disa sqarime konkrete. Është hera e parë që Buxheti komunal i

Komunës së Dragashit ka këtë vlerë, ose është vlera më e madhe që ndonjëherë ka pas Komuna e Dragashit deri më tash. Vlera totale Buxhetit komunal për vitin 2025 është 12,320,000 euro.

Nga këto, 551,000 euro janë të hyra vetanake, që realisht, buxheti komunal i Komunës së Dragashit për vitin 2025 kap vlerën 12,872,000 euro. Ky Buxhet ndahet në Grantin e Përgjithshëm, i cili është 7,135,000 euro; Granti Specifik i Arsimit që kap shumën 3,688,000 euro; dhe Granti Specifik i Shëndetësisë i cili është 1,481,000 euro. Të gjitha këto mjete janë të ndara në investime kapitale, mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale. Prandaj, Pagat dhe Shtesat kapin vlerën 6,154,000 euro; Mallrat dhe Shërbimet kapin vlerën 1,513,000 euro; Shpenzimet Komunale kapin shumën 400 mijë euro; Subvencionet kapin shumën 400 mijë euro; Shpenzimet Kapitale janë 4,404,000 euro. Në total janë 12,872,000 euro buxhet për vitin 2025. Se a janë përfshirë të gjitha kategoritë, unë mund të ju them se ky Buxhet është ndarë në këto programe apo zyra. Zyra e Kryetarit kap vlerën 330 mijë euro; Administrata 633 mijë euro; Zyra e Kuvendit 280 mijë euro; Drejtoria për Ekonomi dhe Financa 220 mijë euro; Shërbimet Publike 530 mijë euro; Zyra për Komunitete 55 mijë euro; Bujqësia 195 mijë euro; Kadastri 49 mijë euro; Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis 4,310,000 euro; për Mirëqenien Sociale 1,588,000 euro; dhe Shërbimet Primare 552 mijë euro. Pra, të gjitha këto mjete – 12,872,000 euro – në vlerë totale janë ndarë nëpër të gjitha drejtoritë. Prandaj, për investime kapitale unë besoj se lista ka qenë e publikume në uebfaqe, në qoftë se keni nevojë me e lexue, do të marrë shumë, janë mbi 65 projekte të cilat janë të emëtueme veç e veç ku do të bëhen investimet kapitale nëpër fshatra. Unë do të kisha pas dëshirë që në radhë të parë të marrim pyetjet prej panelistëve, edhe në qoftë se kanë pyetje të veçanta për vende të veçanta, me mund me iu dhënë sqarime, për mos me shkue në veçanti me i lexue të gjitha këto, sepse do të marrin shumë kohë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, drejtor! Fjala është për ju!

Lindita Kozmaqi Piraj, zyrtare për Barazi Gjinore: Përshëndetje për të gjithë! Faleminderit kryesueses, drejtorit dhe të gjithë anëtarëve të Komitetit për këtë mundësi. Është ndoshta hera e parë që mbahet një formë e tillë e një debati për çështje të Buxhetit. Unë nuk pata diçka specifike, por ne i kemi listat me projekte të cilat janë të parapara, sigurisht prej kërkesave të qytetarëve dhe takimeve që keni mbajtur me banorë, për infrastrukturë. Por, ne kemi mbajtur edhe takim vetëm me gratë, me kryesuesen bashkë. Kështu që, ne kemi iniciativa që kanë dalë specifikisht për nevojat e grave dhe vajzave. Kemi marrë premtimin që këto do të futen në Buxhet. Kështu që kisha pas qef, qoftë nga ana juaj, apo edhe e kryesueses, që për hir që gratë janë këtu, të marrim një përgjigje, çka do të ndodhë me iniciativat e tyre, sepse në listë nuk i shohim. Ato kanë të bëjnë më tepër me aspektin social, nuk janë infrastrukturë.

Dilber Halimovic, banor i fshatit Mlikë: Përsëritet, jam Dilber Halimovic nga fshati Mlikë. Nuk jam ekonomist dhe nuk di shumë për ekonomi, të gjitha këto që drejtori i ceku më lartë, mua më intereson se si janë caktuar prioritetet për fshatrat. Këtu në lajmërimin tuaj nuk mund ta gjej fshatin Mlikë, sikurse nuk është planifikuar hiç për këtë fshat, ndërsa kemi shumë probleme. Problemet veç po grumbullohen, a nuk po zgjidhen. Një ndër problemet është se kur të shpallet tenderi, dikush e fiton atë tender, pa marrë parasysh a janë kubëzime, ujësjellës ose diçka tjetër, organi mbikqyrës nuk e di se si e kryen funksionin e vet. Ne në fshat asnjë projekt nuk e kemi parë që është përfunduar deri në fund. Si të kryhet tenderi, bëhet pagesa, forma i tërheq punëtorët dhe nuk e kqyr punën a e ka kryer deri në fund. Mund të jua përmend disa, vetëm nuk dua që t'ia marrë kohën, mund të jua përmendi disa tenderë të cilët nuk janë përfunduar. Një punë e mirë është bërë që duhet ta përmendi, vitine kaluar është bërë ndërrimi i gypave të ujësjellësit. Unë e di që këtë punë e ka bërë firma e Fatonit. Kemi bërë kubëzimin e rrugëve, kemi pastruar lumin dhe kemi bërë kanalizimin. Pas disa ditëve, kanali është zënë dhe kanë mbetur katër puseta të pambuluara. Është dashtë të ndërrohen tetë shtylla elektrike, janë ndërruar vetëm katër. Janë hapur gropat dhe nuk janë vendosur, sot e asaj kohe rrjeti elektrik shkon nëpër disa drurë. Unë dua ta bëj një pyetje: çfarë po bën organi mbikqyrës? Për çka iu bëhet pagesa firmave të cilat e kanë pranuar një punë dhe nuk e kanë kryer. Këtë duhet ta kontrollojë Zyra për Ekonomi dhe Financa. Unë propozoj që të bëhet një mbledhje dhe të thirren të gjithë përfaqësuesit e fshatrave, të konsultohet në lidhje me këto dhe kësaj çështjeje t'i vihet fundi. Nuk kisha me ju marrë më shumë kohë, sepse ky është një planifikim për vitet 2025-2027. Nuk kisha qef të kthehem mbrapa, po ky është një propozim i imi se si të punohet në të ardhmen dhe bashkëpunimi të jetë sa më i mirë. Ata të cilët e fitojnë tenderin, Komuna është e obliguar që ta bëjë një kontroll për punën e tyre dhe kur të vijnë firmat në fshat, nuk i lajmërohen askujt prej fshatarëve se çka do të bëjnë dhe kur do ta fillojnë punën. Dua ta falënderoj inxhinierin e ndjerë, Sabahat Hasanin, ai na ka dalë gjithmonë në ndihmë dhe na ka tregue se çka duhet të punohet, dhe njëherit përmes tij jemi informuar për punimet që janë zhvilluar në fshatin tonë. Zyra e Kadastrës gjithmonë neve na ka dalë në ndihmë, mirëpo me firmat të cilat e fitojnë tenderin dhe i kryejnë punët, bashkëpunimi nuk ka qenë në nivel. Të na tregojnë se çka duhet të punohet, ata vijnë me disa fotografi satelitore, tregojnë kjo është kjo, kjo është kjo dhe diçka që nuk u pëlqen nuk na tregojnë. Unë si fshatar, më vjen keq se nuk e di gjuhën shqipe, që të kuptohem me ta për çdo gjë e cila nuk është e zgjidhur, ata më kërkojnë që të flas shqip. Mua më vjen keq që nuk e di gjuhën shqipe. Faleminderit!

Abaz Qengaj: Ju dëshiroj punë të mbarë, edhe juve që keni ardhë ju dëshiroj mirëseardhje! Gjithashtu edhe vetvetes i dëshiroj mirëseardhje, se nuk kam qenë ndonjëherë më parë në këso mbledhje të rëndësishme ku flitet për të ardhmen tonë. Unë vërtet mbeta i fascinuar nga Buxheti, 12 milionë e ca

mijë euro, që për Komunë tonë kujtoj që janë të bollshme – megjithëse nuk janë asnjëherë të bollshme – por mendoj se mund t'i përmbushim disa nga kërkesat tona që i kemi. Nuk ka kaluar as dy muaj të plotë që kemi pas një gjendje jashtëzakonisht të rëndë në Komunë, dhe po e shoh, Buxheti është i formuar pas asaj gjendjeje, këtu në këto farë statistikat ku i keni bërë ju, ku i keni qit këto të dhënat për katundet. Nuk pashë askund që të ketë një rrugë për të gjithë fshatrat që të ketë një buxhet të ndarë, ku ne aludojmë sa herë që vijnë të huajt, se ne dëshirojmë të bëhemi një Komunë turistike dhe tërë Komunën e kemi të mbushur me bërlllog. Unë në vitin 2000, me gjermanët propozuam dhe e bëmë gazetën “Ditët e Shpresës”, e cila u botua disa vjet me radhë. Në numrin e parë të asaj gazete unë kam shkruar për deponitë ilegale që mbretërojnë në Komunën tonë. Ju e dini fare mirë se në disa katunde të Komunës sonë ende nuk funksionon grumbullimi i hedhurinave. Deshta s'deshta unë, diku do t'i gjuaj, meqë jam i një katundi që nuk tubohen hedhurinat. Ato hedhurina unë i gjuaj diku, jam një nga ata shkaktarët kryesorë që e ndoti ambientin. Të them të drejtën, kur është bërë kanalizimi i fshatit Kuk dhe Kosavë, rastësisht kam qëlluar aty. Ndërkombëtari kur ka ardhë aty, tha çfarë është ky bulduzher kaq i madh, tha do ta bëjmë një sistem të kanalizimit të dy këtyre fshatrave. Unë thashë, po shikone edhe një fshat është nalt atje, thashë janë njerëzit më arrogantë në Komunë, njerëzit më të këqinj në Komunë, njerëzit të cilët nuk duhet të jenë në këtë Komunë. Tha pse, i thashë: ju sa të doni pastrone Kosaën, kur ata janë ndotësit kryesorë. Prandaj, do të kisha lut juve, meqë nuk ka kaluar ende në Kuvend, ta rishikoni një mundësi. Ka shoqata mjaft tonat, këtu të Komunës, që mund të ndihmojnë, kemi mjaft shkolla, që një ditë mund ta shpallin ditë të pastrimit të Komunës, edhe të marrim krejt të dalim në rrugë, të heqim letra, të heqim bërllloge. Bërllloget tona, ju lutem, se kërkush nuk na i bjer nga askush. Duhet të vetëdijesohemi ne – të gjithë vikendeve nëpër bjeshkë shkojmë me qese plastike deri atje, kurse asnjë qese plastike nuk e mbushim për me e prur në shpi teposhtë. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Po më vjen mirë që u parashtruan këto pyetje. Sa i përket iniciativës së grave, unë besoj se keni bërë një punë shumë të mirë. Gjithashtu, janë paraparë me buxhet, për arsye se të gjitha kërkesat të cilat janë, i takojnë natyrës së shëndetësisë dhe problemeve sociale të grave, të cilat ne nuk dimë sa mund të jetë numri. Por po aq sa kanë nevojë, që paraqiten, mjetet janë ndarë nga mallrat dhe shërbimet, dhe secila femër e cila ka nevojë për një trajtim të një problemi të tillë, do t'i mbulohen shpenzimet, meqenëse do të merret ai vendim pikërisht në Kuvend, pa u diskutue, meqenëse jemi marrë vesh me kryetaren dhe me zyrtaren për Barazi Gjinore. Mjetet ekzistojnë, vullneti politik ekziston, ky problem tash e tutje do të jetë i zgjidhur për femrat e Komunës sonë. Sa i përket përfaqësuesit e fshatit Mlikë, të falënderoj shumë për problemet e fshatit që po interesohesh, në radhë të parë. Përpjekjet tona janë të përbashkëta, që të biem në kontakt gjithsesi me qytetarët, t'i shohim

ato projekte. Jo që detyrimisht jemi të kënaqur edhe ne me disa operatorë ekonomikë të cilët po na i kryejnë punët. Nuk është rasti vetëm në Mlikë, kemi edhe raste nëpër fshatra tjera. Por jemi duke u munduar me e bo më të mirën të mundshme që ato probleme t' zgjidhim. Edhe po më vjen mirë që i paraqite do problem, por do të ishte mirë që Zyra e Kryetarit është e hapur 24 orë. Të vini dhe të uleni, të bisedojmë për problemet konkrete të fshatit Mlikë dhe të gjejmë një zgjidhje sa më të mirë të mundshme për ato probleme. Unë besoj se për vitin tjetër i keni 30 mijë euro të ndara, e di edhe atë se nuk janë të mjaftueshme, sepse nevojat janë më të mëdha. Mirëpo, mund të gjejmë edhe hapësirë për projekte emergjente që kanë nevojë sa më shpejt të kryhen. Të gjejmë edhe mënyra me i realizue edhe ato projekte për të cilat ju keni nevojë dhe në qoftë se ka domosdoshmëri. Sa i përket asaj se çfarë tha Abazi, është me të vërtet shqetësuese. Ne e kemi paraqit një projekt në Bashkimin Evropian, ku janë të parapara mbyllja e katër deponive ilegale të cilat funksionojnë për grumbullimin e mbetjeve inerte, ku edhe në ato katër deponi ilegale, përveç mbetjeve inerte kanë fillue të qesin edhe hedhurina. Kanë kalue koncept notën, pritet për investime, kemi bo shpronësimin, i kemi përcaktue dy lokacione - një në territorin e Opojës, një në të Gorës - që t'i funksionalizojmë dy deponi dhe që të fillojmë me pastrimin e ambientit. Realisht, prej se kemi ardhë në pushtet, kemi bo qa shumë përpjekje dhe investime në kompaninë ekzistuese për grumbullimin e mbeturinave, që ta mbajmë sa më mirë ambientin të pastër. Edhe pse disa fshatra nuk janë të kyçura, shpresoj se me miratimin edhe të Rregullores, që në seancën e fundit është me e miratue, do të arrijmë suksese tjera dhe do të bëjmë përpjekje që ta kemi ambientin sa më të pastër. Pajtohem plotësisht se mbrojtja e ambientit na kushton shumë në zhvillimin ekonomik të Komunës së Dragashit, e konkretisht në turizëm.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, drejtor! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë faleminderit shumë për pjesëmarrjen! Siç e thashë edhe ma herët, në fund të muajit shtator pritet me ardhë në Kuvend buxheti, edhe besoj se do të votohet. Faleminderit shumë!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/pKBMnkNFirwstPB6/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/JRZedPtf7A3CB5e8/>

Në uebfaqe:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/komiteti-per-politike-dhc-financa-organizoi-sot-degjim-publik-me-qytetare-per-projekt-buxhetin-e-komunes-se-dragashit-per-vitin-2025/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/st/news/komitet-za-politiku-i-finansije-organizovao-jc-danas-javnu-raspravu-sa-gradjanima-o-nacrtu-budzeta-opstine-dragas-za-2025-godinu/>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 04.09.2024

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR
ME QYTETARË PËR BUXHETIN E VITIT 2025
ORGANIZUAR NGA KRYESUESJA E KUVENDIT DHE KPF-ja

LISTA UÇESNIKA NA SASLUŠANJE BUDŽETA SA GRADANIMA ZA
BUDŽET ZA 2025 GODINU
ORGANIZOVANO OD PREDSEDAVAJUĆE SKUPŠTINE I KPF-a

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Etnia	M	F	Nënshkrimi
Br.	Ime i Prezime	Prebivalište	Etnička pripadnost	M	Ž	Potpis
1	URIM BEQIRI	KERKE	SHQIPTAR	V		[Signature]
2	Huron Dautovic	KRANIŠT	GORANAC	M		[Signature]
3	DILBER HALIĆ	MAJKE	GORANAC	M		[Signature]
4	Hara Saiti	Xerxe	Shqiptar		F	[Signature]
5	Hona Saiti	Xerxe	shqiptar		F	[Signature]
6	Abet Adilahi	Kule	Shqiptar	M		[Signature]
7	Jonat Janyri	Kosovë	Shqiptar	M		[Signature]
8	IBRAHIM KRYEZIU	KERKE/PANOR	Shqiptar	M		[Signature]
9	Dreni Myrëzari	Zaplluxhe	SHIPTAR	M		[Signature]
10	Veton Qafleshi	Bellobrad	Shqiptar	M		[Signature]
11	Behar Selmani	Kuk	Shqiptar	M		[Signature]
12	Andit Keluderi	Kosovë	Shqiptar	M		[Signature]
13	Muhamet Berisha	Pruce	Shqiptar	M		[Signature]
14	Veton Haxhi	Zaplluxhe	Shqiptar	M		[Signature]
15	AURITA SAITI	BRUT	SHQIPTAR	F		[Signature]
16	LINDITA PIKAT	Pruce	shq	F		[Signature]
17	ELA QAFLESHI	BELLOBRAD	SHQIPTARE	F		[Signature]
18	MYZERETE QAFLESHI	BELLOBRAD	SHQIPTARE	F		[Signature]
19	Bajrieta Selimi	Blaç	Shqiptare	F		[Signature]
20	ADELINA DAUTI	Dragash	Shqiptare	F		[Signature]
21	Nedsmilina Spilcan	Papjos	GORANAC	M		[Signature]
22	Erona Zyberi	Dragash	Shqiptare	F		[Signature]
23	Kadire Bajrami	Brut	Shqiptar	F		[Signature]
24	HO RAZA	PRISTE	GORANAC	M		[Signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

01 Nr. 400/01-24002/24
 04.09.2024
Dragash - Dragaš

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Gjakovës
Qyteti i Gjakovës

20____
Gjakovë • Kosovë

25	ZIADET AGA PESTICA BURRA			M	
26					
27	ARTAN LOSHAJ	DRAGASH	SHQIPETAR	M	
28	AKIJETA GJERAJ	DRAGASH	SHQIPETAR	F	
29	Munir JONUN	Lapja	KOSOVA	M	
30	BAMIR KOLLARI	MAQELI	SHQIPETAR	M	
31	RESUL FETAHY	KUKES	SHQIPETAR	M	
32	AGAS GJERAJ	DRAGASH	SHQIPETAR	M	
33	Adem ENHUR	DRAGASH	SHQIPETAR	M	
34					
35					
36					
37					
38					
39					
40					
41					
42					
43					
44					
45					
46					
47					
48					
49					
50					
51					
52					
53					
54					
55					
56					
57					
58					
59					
60					
61					
62					
63					
64					
65					
66					
67					
68					
69					

